REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

## KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
## TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga Prefekti Qarkut Dibër dhe mban nga dërguesi nr 1112/1 prot datë 14.11.2022 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes( lënda)

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr.hyrës prot 5249/1 datë 16.11.2022

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z Sekretarit të Këshillit Bashkiak

-Znj/Z

-Znj/Z Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

-Znj/Z

me porosinë:

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore( përgjigjes,..etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

Peshkopi, më 16.11.2022

BASHKIA PESHKOPI
Nr. 5249/1 Prot.
Data 16/11/22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1112/1.prot.

Peshkopi, më 14.11.2022

Lënda : Për vendimet nr. *( 95, 96, 97 dhe 98 )* , datë 09.11.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Pranë nesh , janë depozituar për njohje vendimet nr. *( 95, 96, 97 dhe 98 )* , datë 09.11.2022 , të Këshillit të Bashkisë Dibër, me objekt "heqje dhe dhenie mandati këshilltari", vendime të cilat për të gjitha efektet ligjore janë akte të karakterit individual, për pasojë janë jashtë sferës së kompetencës së Prefektit të shprehet lidhur me to, autoritet i cili mbështetur në ligjin nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, verifikon vetëm ligjshmërinë e akteve me karakterit normativ.

Nisur sa siper vendimet e ardhura pranë nesh , hyjnë në fuqi menjëherë, sipas parashikimit të paragrafit të fundit të nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore për hyrjen në fuqi të akteve administrative të karakterit individual.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-PREFEKTI I QARKUT DIBËR

*Adresa : Bulevardi "Elez ISUFI" Peshkopi, Albania, Tel. 00355 218 2- 2082,Tel 00355 218 2– 2631, E-mail prefekturadiber@gmail.com*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

Nr. 5249 Prot

Peshkopi, më 10.11.2022

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Komisionit Zgjedhor të Zgjedhjeve

**Për dijeni**: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për dijeni Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër **Nr.95**

**Datë: 09.11.2022**

**"Për heqje të mandatit të Këshilltarit z.Besmir Markeci ."**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Afrim Mikli**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

**VENDIM**

**Nr 95 Datë 09 / 11 /2022**

**" Për heqje të mandatit të Këshilltarit"**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 " Përvetëqeverisjen vendore" neni 49 pika 4/e,pika 5, neni 54 shkronja "j", neni 55 pika 3;, për mospjesëmarrjen në mbledhje për 6 muaj të këshilltarit z. Besmir Markeci Partia Socialiste e Shqiperise (Aleanca për Shqipërinë Europiane), Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **09.11.2022** më 16 vota pro,0 kundër dhe 0 apstenim,

**VENDOSI:**

1. Heqjen e mandatit të këshilltarit z.**Besmir Markeci**
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Njoftohet për vendimin e lartëcituar KQZ dhe Prefekti i Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall sot me date **09.11.2022**

**Kryetar Këshilli**
**Sokol Sava**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR